



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Vendim i Këshillit të KPM-së në lidhje me aplikacionet për TV stacion lokal në Mitrovicë

Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media, në takimin e mbajtur më 7 shkurt 2008, vendosi të shpallë tender për dhënien e një licence të përkohshme, për stacion televiziv në gjuhën shqipe në komunën e Mitrovicës, deri në fazën e ri-licencimit.


Më 13 shkurt 2008, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) shpalli tenderin për licencë për TV stacion lokal në gjuhën shqipe në Mitrovicë, i cili përfundoi më 14 mars 2008, në ora 17:00. Gjatë kësaj periudhe në KPM janë paraqitur gjashtë (6) aplikacione për shërbim transmetimi televiziv në Mitrovicë në gjuhën shqipe.

KPM ka pranuar aplikacionin e “VISA CHANEL” të identifikuar si “Kandidati 1T”; aplikacionin e TV MITROVICA PLUS” të identifikuar si “Kandidati 2T; aplikacionin e “TV MITROVICA” të identifikuar si “Kandidati 3T”; aplikacionin e “TV MITROVICA-M1” të identifikuar si “Kandidati 4T; aplikacionin e “TV YLBERI” të identifikuar si “Kandidati 5T” dhe aplikacionin e “IBRI TV” të identifikuar si “Kandidati 6T”.

KPM ka vlerësuar vetëm aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse të cilat janë sjell nga kandidatët brenda afatit të përcaktuar nga Këshilli i KPM-së. Aplikacionet janë vlerësuar në bazë të Rregullores së KPM-së 2005/1, “Cilësitë për Marrjen e Licencës së Transmetimit” dhe kriterëve të përcaktuara nga Këshilli në tenderin e shpallur më 13 shkurt 2008 .

Këshilli i KPM-së, në takimin e vet të mbajtur më 10 maj 2008 ka shqyrtuar të gjashtë (6) aplikacionet dhe ka konkluduar që këtyre aplikacioneve ju mungon dëshmia e qëndrueshmërisë financiare. Këshilli ka vendosur që të diskualifikojë të gjitha aplikacionet.

Në emër të Këshillit të KPM-së.


Argjentina Grazhdani
Kryesues e Këshillit të KPM-ës



Ref. 0805/0688/CIMC/ag
Prishtinë, 12 maj 2008